



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT KUKËS

Nr. _____ Prot.

Kukës, më ____/____/ 2025.

Lënda: : Informacion mbi veprimtarinë e Prefektit Qarkut Kukës për Muajin Korrik 2025.

Z. Ervin Hoxha Ministër i Brendshëm

TIRANË

Në zbatim të Ligjit Nr. 107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, Urdhërit Nr.667, datë 18.12.2018 të Ministrit të Brendshëm "Për raportimin dhe informimin mbi veprimtarinë e Prefektit të Qarkut", (Shtojca 1), ju informojmë për veprimtarinë e punës së administratës së Prefektit të Qarkut Kukës për muajin Korrik 2025:

I-Informacion në lidhje me ushtrimin e funksionit të Prefektit të Qarkut e Administratës së tij.

Në funksion të ligjit Nr.107/2016, "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar gjatë muajit Korrik 2025 nga Administrata e Prefektit të Qarkut Kukës, ka vazhduar puna në funksion të realizimit të detyrave ligjore si dhe të programit të Qeverisë Shqiptare. Veprimtaritë e Prefektit për këtë muaj janë si më poshtë:

Prefekti i Qarkut ka zhvilluar takim me drejtorin e Ujësjetës Kanalizime Kukës, në lidhje me orarin e furnizimit me ujë të pijshëm për gjithë Qarkun, ku ka kërkuar që të ngrihet një grup kontrolli për monitorimin e kësaj shtate për lidhje të paligjshme që mund të ketë në disa fshatra.

Prefekti i Qarkut zhvilloi një takim pune me Anëtarët e Task-Forcës Lokale Ndërinstitucionale, në funksion të ndjekjes dhe vlerësimit të ecurisë së Sezonit Turistik Veror, ku temë kryesore ishte ndjekja e mbarëvajtjes së sezonit turistik, me fokus në: Zbatimin e detyrave sipas planit të masave, Identifikimin e problematikave të hasura, si dhe propozime konkrete për përmirësim dhe garantim të standardeve të shërbimit për turistët vendas dhe të huaj.

Prefekti ka realizuar takim me Ambasadorin e OSBE në Shqipëri z.Michel Tarran,ku temë diskutimi ishte ecuria e turizmit, lidhur kjo me zhvillimet infrastrukturore, aeroportin nëse është funksional dhe kur pritet të ketë fluturime, koordinimit të punës së institucioneve në drejtim të parandalimit të trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shtimi i vëmendjes ndaj të punësuarve që vijnë nga jashtë) si dhe luftën kundër shfaqjeve të ekstremizmit të dhunshëm, ku në fokus ishte mirëfunksionimi i komiteteve drejtuar nga Prefekti.

Prefekti ka realizuar takimin me anëtarët e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Prefekti bashkë me N/Prefektët e Hasit dhe Tropojës kanë ndjekur me përparësi mirëfunksionimi i pushtetit vendor dhe problemet që kanë të bëjnë me rendin dhe sigurinë në Qark,qarkullimin rrugor, mbrojtja civile, emergjencat dimerore, shëndetësore, shërbimi spitalor, problematikave të shëndetësisë, turizmin si dhe ruajtja e pastrimi i mjedisit. Kemi dërguar në mënyrë periodike informacionet tek ZOS, dhe tek Drejtoria e Çështjeve Vendore dhe Funksioneve të Deleguara në Ministrinë e Brendshme.

II-Sektori i Planifikimit Përballimit të Emergjencave Civile dhe Krizave

Është ndjekur nga Sektori i PPEC dhe Krizave situata për emergjencat e periudhës në territorin e Qarkut Kukës. Është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me Qendrën Kombëtare Operacionale të EC-së, AKMC-në dhe strukturat e Mbrojtjes Civile të bashkive për situatat, që janë krijuar gjatë periudhës, duke marrë e dhënë informacionet përkatëse. Ju është dërguar situata meteorologjike mbi parashikimin e motit bashkive Kukës, Has dhe Tropojë (Përgjegjësve të Strukturave aktive të EC-së) me qëllim marrjen e masave parandaluese për ndonjë situatë emergjente. *Kemi dhënë informacionet ditore për situatat emergjente në shkallë Qarku.*

Për muajin Korrik 2025 kemi patur 23 (njëzet e tre) raste situatash të emergjencave civile e konkretisht: Në bashkinë Kukës 6 (gjashtë) rastë zjarri në pyje dhe kullota, në Bashkinë Has 7 (tetë) rastë zjarresh dhe në Bashkinë Tropojë 10 (dhjetë) rastë zjarri. Sipas Planit Kontrollit të miratuar nga Prefekti i Qarkut u ushtrua kontroll në bashkitë e Qarkut Kukës, strukturat përgjegjëse të EC-së “Për hartimin e Planit të Emergjencave Civile dhe Dokumentave të Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel lokal”. *Ju është dërguar shkresë Këshillit të Qarkut Kukës, bashkive Kukës, Has, Tropojë, Institucioneve e Degëve territoriale, “Mbi marrjen e masave për parandalimin dhe përballimin e zjarreve gjatë sezonit veror, në kuadër të zbatimit të Planit të masave për Emergjencat Civile”.* Është dërguar në MB informacion mbi masat e marra për parandalimin dhe përballimin e zjarreve gjatë sezonit veror 2025 në Qarkun Kukës. Është dërguar informacion mbi situatat emergjente të ndodhura në Qarkun Kukës për çdo javë tek MB (sektori i emergjencave). *Është përpunuar informacioni i ardhur nga bashkitë mbi evidentimin e kapaciteteve akomoduese për strehimin e përkohshëm në raste të fatkeqësive natyrore. Është përgatitur raporti progresiv i ngjarjeve të ndodhura për muajin Korrik 2025 në Qarkun Kukës sipas bashkive.* Është ndjekur zbatimi i Programit “Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore” nga bashkitë, për projektet e financuara nga AKMC. Përditësimi i statistikave të objekteve dëmtuar sipas llojit të fatkeqësive, në bashkitë Kukës, Has, Tropojë dhe shkallë Qarku. Përditësimi i Rregjistrit të Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë në shkallë Qarku (Bashkitë Kukës, Has, Tropojë) dhe raportimi në AKMC. Ju dërgua kërkesë AKMC-së për dhënie ndihme të një familje bashkia Tropojë dhe kthim përgjigje për refuzimin e kësaj kërkesë bashkisë Tropojë. *Kthim përgjigje zj. E. Muldaka bazuar në kërkesën e saj drejtuar Prefektit të Qarkut Kukës.*

Ju është kthyer përgjigje të gjitha shkresave të ardhura në adresë të Prefektit të Qarkut, për problematikat që kanë të bëjnë me Sektorin e Emergjencave Civile. *Ju është dhënë përgjigje qytetarëve për kërkesat që kanë të bëjnë me problematikat e emergjencave civile.*

Sektori Juridik.

Gjatë muajit korrik kemi verifikuar ligjshmërinë për 9 akte, nga të cilat: 3 akte të këshillit bashkiak Kukës, 3 akte të këshillit bashkiak Has, si dhe 3 të këshillit bashkiak Tropojë. Kemi regjistruar në regjistrin elektronik aktet e hyra për verifikim ligjshmërie. Kemi marrë pjesë në takim me Prefektin dhe me Sekretarin e Përgjithshëm ku e kemi informuar mbi punën e kryer nga sektori juridik dhe kemi marrë detyrat për javët në vazhdim. Kemi regjistruar në regjistrin elektronik aktet e hyra për verifikim ligjshmërie. Kemi shqyrtuar 12 praktika shkresore (leje drejtimi të shtetasve të huaj) të sjella nga Drejtoria. Janë shënuar lejet e drejtimit në regjistrin e lejeve të drejtimit. Është bashkëpunuar me sektorët e tjerë për problematika të ndryshme, si dhe për verifikimin e ligjshmërisë së akteve. Janë përgatitur njoftimet drejtuar njësive të vetëqeverisjes vendore, për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative. Janë përgatitur planet e kontrollit për verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore. Bazuar në planin e kontrollit nr.587/1 datë 14.07.2025 është ushtruar verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve normative në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore Kukës. Janë përgatitur akt konstatimet mbi verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, dhe janë dërguar për nënshkrim. Është përgatitur relacion për të informuar Prefektin mbi verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve normative në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Kemi marrë pjesë në takimi e zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në kuadër të projektit Bashki të forta. Është përcjellur kërkesa e disa taksistëve të bashkisë Kukës, Albania Highway Concession. Kemi në shqyrtim 2 kërkesa të ardhur

nga qytetarë. Kemi përgatitur planin e punës për muajin Gusht 2025 të Sektorit Juridik. Kemi përgatitur analizën e muajit Korrik 2025 të Sektorit Juridik. Kemi përgatitur listë-prezencën e Sektorit Juridik për muajin Korrik 2025. Kemi përgatitur pasqyrën e akteve për muajin Korrik. Kemi përgatitur informacionet javore për Prefektin. Kemi përgatitur informacionet javore për tek ZOS-i.

Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara.

Raportet ditore, javore dhe mujore nga sektori janë dërguar në mënyrë korrekte në kohën e duhur dhe sipas kërkesave të institucioneve në nivel qendror dhe vendor.

Është përgatitur informacioni për raportin e Prefektit Qarkut Kukës për muajin Korrik 2025 që dërgohet në Ministrinë e Brendshme. Është dërguar shkresë “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së Murtajës së Ruminantëve të Vegjël në qarkun Kukës. Është dërguar bashkive Kukës, Has dhe Tropojë, me shkresë, Urdhrin nr. 630, datë 27.06.2025, të ardhur nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, për njohje dhe zbatim. “Ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhën dhe dhi në territorin e Republikës së Shqipërisë.” Janë dërguar njoftimet për takimin që do të zhvillohet me anëtarët e Komitetit Rajonal për Parandalimin e Radikalizmit dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Është hartuar dhe zbatuar Plani i Kontrollit për monitorimin e stacioneve të MZSH-ve, mbi zbatimin e masave inspektuese dhe parandaluese për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, gjatë periudhës verore, në territorin e bashkisë Kukës, Tropojë dhe Has. Është përgatitur informacion për Prefektin, për zbatimin e Planit të Kontrollit të MZSH-ve. Është dërguar në Ministrinë e Brendshme me shkresë dhe në mënyrë elektronike, raportimi për periudhën 6-mujore Janar-Qershor 2025 mbi punën e bërë për Luftën kundër Trafikimit të Personave dhe plotësimi i formatit në zbatim të Planit të Veprimt. Është punuar për përditsimin e KRAT-it dhe TTAT-së, sipas urdhërit të ri të ardhur nga Kryeministri nr.91, datë 27.06.2025. Është dërguar shkresës “Informacion mbi gjendjen e akteve rrugore dhe urave në Bashkitë Kukës dhe Has” për kompetencë Autoriteti Rrugore Shqiptare, Është dërguar shkresë Bashkisë Kukës dhe Has, për komptence për problematika dhe gjendjen e akteve rrugore dhe të urave. Kërkesë për informacion, Bashkisë Kukës në lidhje me peticionin e banorëve të fshatit Buzmadhe “ Kundër ndërtimit të Hec-it në Buzmadhe”. Është kthyer përgjigje me email, Inspektoriatit Shtetërorë i Mbikëqyrjes së Tregut, për takimin që do të organizohet mbi sigurinë e ashensorëve në territorin e qarkut Kukës. Është zhvilluar takimi me përfaqësuesit e ISHMT-së, për kontrollin dhe sigurinë e ashensorëve në qarkun Kukës. Është dërguar shkresës Bashkisë Kukës. Tropojë dhe Has, për numrin e ashensorëve dhe gjendjen e tyre. Është përgatitur Plani i Kontrollit, “ Për mbetjet Spitalore Kukës, Has e Tropojë. Është kthyer përgjigje me email, “Mbi monitorimin e zbatimit të masave të Planit të Veprimt 2024-2026 të Strategjisë Ndërsëktoriale të Sigurisë në Komunitet 2021-2026, për periudhën Janar-Qershor 2025”. Është marrë informacion për furnizimin me energji elektrike dhe ujë në Qarkun Kukës. Është përgatitur informacioni javor i sektorit për ZOS-in në Ministrinë e Brendshme Gjatë muajit Qershor janë legalizuar 57 dokumenta për jashtë shtetit në shkallë Qarku, këto të ndara; Bashkia Kukës 41, Bashkia Has 9 dhe Bashkia Tropojë 7.

Sektori i Zhvillimit Urban.

Takim pune me Prefektin e Qarkut, analiza e veprimtarisë së punës së SZHU për javën e kaluar si dhe marrjen e detyrave për javën në vazhdim. Mbledhja e Task-Forcës Ndërinstitucionale e Sezonit Turistik Veror 2025. Dërgim informacioni Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Brendshme dhe Prefektit të Qarkut Kukës rreth mbledhjes së Task-Forcës Ndërinstitucionale e Sezonit Turistik Veror 2025. Hartimi i Planit-Punës për Sektorin e Zhvillimit Urban për muajin Korrik. Informacion mujor për veprimtarinë e SZHU, Qershor 2025. Plotësim i tabelës Tip të Ministrisë së Brendshme me të dhënat mujore për: Numrin e vizitotëve, Vizitorët në objektet e trashigimisë kulturore, Masat e marra për sezonin turistik veror 2025, Inspektimet e kryera nga IKMT Kukës.

Informacion drejtuar Prefektit të Qarkut Kukës si dhe Kryeministrit në lidhje me situatën e sezonit turistik 2025 në Qarkun Kukës, masat e marra dhe problematikat e konstatuara. Informacion drejtuar Prefektit të Qarkut Kukës si dhe Kryeministrit në lidhje me situatën e sezonit turistik 2025 në Qarkun Kukës, masat e marra dhe problematikat e konstatuara. Shkresë bashkive të Qarkut Kukës, kërkim informacioni mbi ecurinë e aksionit për lirim të hapësirave publike. Në kuadër të detyrave institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitucional, Përgjegjësi i Sektorit të Zhvillimit Urban mori pjesë dhe ndoqi nga afër procesin e fillimit të procedurave të privatizimit të Ndërmarrjes Gjeologjike Tropojë, në bashkëpunim me D.SH.P Shkodër dhe Shërbimin Gjeologjik Shqiptar.

Informacion me shkrim drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me detyrat e lëna nga audit i Ministrisë së Brendshme, kontratat e qirave dhe huapërdorjes. Në kuadër të bashkëpunimit u mor pjesë në trajnimin mbi “Parandalimi dhe reagimi ndaj Zjarreve në zonat e mbrojtura; Roli i Stafëve lokale dhe komunitetit” në kuadër të projektit “Mbrojtja dhe përdorimi i qendrueshëm i zonave të mbrojtura ndër-kufitare të malit të Sharrit, Mavrovës dhe Korab-Koritnik”. Plan kontrolli i SZHU për monitorimin e bashkive Kukës, Has dhe Tropojë me temë: Rreth aksionit për lirim të hapësirave publike në territoret administrative të bashkive.

Masat e ndërmarra për të garantuar rigjenerimin urban, mbrojtjen e mjedisit të zhvillimit të qëndrueshëm të pejsazheve dhe të hapësirave të gjelbra. Planifikimet nga bashkia të projekteve të integruara me qasje të qëndrueshme (mjedisore, sociale, ekonomike). Politikat apo masat për mbrojtjen e burimeve natyrore dhe hapësirave të gjelbërta. Korrespondenca e ardhur në adresë të Institucionit të Prefektit të Qarkut Kukës, të adresuara këto për Sektorin e Zhvillimit Urban, është përpunuar sipas afateve ligjore. Bashkëpunim me Sektorin Juridik rreth Vendimit të Këshillit Bashkiak Has NR. 60 datë 21.07.2025 “Për Miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve Urbane 2025-2030. Kemi dërguar raportet javore për Z.O.S. Kemi dërguar raportet javore për Prefektin.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse

Janë përpiluar listëpagesat e pagave për muajin Korrik sipas listëprezencave të ardhura nga Përgjegjësit e Sektorëve dhe janë hedhur në sistemin AFMIS. Janë derdhur e kontributet në sistemin e tatimeve për muajin Korrik dhe janë hedhur në sistemin AFMIS për likuidim sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat. Është dërguar evidenca së realizimit të buxhetit të shpenzimeve dhe të ardhurave për 7 mujorin e vitit 2025, referuar regjistrimeve të urdhër pagesave për llogari të periudhës kontabël për dy programet : Administrata dhe Gjendja Civile. Është bërë plotësimi i urdhër shpenzimeve sipas VKM dhe Udhëzimeve përkatëse të cdo fature të ardhur në institucion dhe blerjeve me vlerë të vogël. Është dërguar kërkesa për celje fondi në zerin Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sipas VGJGJLKA në Ministrinë e Brendshme .Dërgim informacioni Prefektit të Qarkut për prezencën e punonjësve çdo ditë pune në orën 08.00 si dhe sa here kërkohet nga ana e tij duke dhënë shpjegimet për lëvizjet apo mungesat, nëse ka. Është dërguar kërkesa për miratimin e lejes së zakonshme për Prefektin pranë Ministrisë së Brendshme. Janë përgatitur urdhërat për leje të zakonshme. Është komunikuar me DAP-in në lidhje me vendet vakante në administratën e Prefektit të Qarkut Kukës si dhe me ASPA në lidhje me programet e trajnimit për punonjësit e Administratës. Është grumbulluar , përpunuar e sistemuar sipas dispozitave ligjore e nënligjore të dhënat dokumentare për secilin punonjës të Institucionit të Prefektit të Qarkut. Janë lëshuar vërtetime për punonjës dhe ish-punonjës së administratës. I është kthyer përgjigje me shkrim shkresave të ardhura në zyrën e Burimeve Njerëzore. Është dërguar informacion në Ministrinë e Brendshme në lidhje me vendet vakante në Administratën e Prefektit të Qarkut Kukës.

AKTIVITETET QË JANË KRYR NË PROTOKOLL/ARKIV

Çdo ditë është bërë protokollimi i shkresave të hyra dhe të dala. Janë bërë verifikimet në inventarin e dokumentave me ruajtje të përhershme për vitin 2012 sipas kërkesës tonë nga perfaqësuesi I DPA-së (Inspektori Rajonal), ku u lanë për të bërë disa ndryshime dhe më pas tërheqja e dokumentacionit.

Është punuar me plotësimin e dosjeve të arkivit me të dhenat përkatëse për vitin 2025, sipas strukturës dhe praktikës së dokumentave. Është bërë kërkim dokumentacioni arkivor nga viti 2012-2024 dhe u është vënë në dispozicion punonjësve të administratës.

Drejtoria Rajonale e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit, Kukës: DRAKU Kukës ka realizuar inspektime në subjekte të ndryshme si markete, supermarkete, furra buke, restorante, çerdhe etj. Nga raportimet e DRAKU Kukës për muajin Korrik ka realizuar 18 inspektime terreni. Janë vendosur 4 masa administrative “paralajmërim”, dhe janë vendosur 3 gjoba. Në pikën e kalimit kufitar Morinë janë realizuar 521 inspektime.

Drejtoria e Rajonale Tatimore Kukës: Drejtoria Rajonale e Tatimeve Kukës për muajin Korrik ka pasur një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Realizimi i të ardhurave është në masën 131% ose 32,357 mijë lekë më shumë se plani. Kontributet e sigurimeve shoqërore shëndetësore janë në masën 111% ose 20,425 mijë lekë më shumë se plani.

Dega Doganore Kukës (Morinë): Për muajin Korrik Dega Doganore Kukës ka kryer 1,871 skanime të mjeteve dhe nuk janë konstatuar raste të trafikimit të lëndëve narkotike dhe mallrave të ndaluara. Realizimi i buxhetit është 67%. Autorizime 12 (dymbëdhjetë).

Drejtoria Vendore e Policisë Kukës: Gjatë muajit Korrik 2025 puna e strukturave të Drejtorisë Vendore të Policisë së Kukësit ka konsistuar në angazhimin maksimal në përf forcimin e zbatimit të ligjit për ngritjen e nivelit të sigurisë publike në të gjithë qarkun. Nëpërmjet bashkëpunimit ndër-institucional është bërë e mundur marrja e informacionit periodik për njohjen e gjendjes së rendit publik e kriminalitetit, sigurisë në qarkullimin rrugor, bimëve narkotike etj, në të gjithë qarkun e Kukësit. Gjatë muajit Korrik, DVP Kukës ka evidentuar **80 vepra penale**, janë zbuluar 76 ose 95% me 80 autorë të implikuar, nga të cilët janë arrestuar/ndaluar 14, proceduar në gjendje të lirë 64 autorë, larguar 2, të ndryshme 0. Për muajin Korrik 2025 janë konstatuar 7 raste të dhunës në familje.

Lufta për parandalimin e kultivimit të bimëve narkotike.

Për muajin Korrik 2025 në të gjithë territorin e Qarkut Kukës janë identifikuar 2 raste të kultivimit dhe trafikimit të bimëve narkotike dhe janë asgjësuar 93 bimë narkotike.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, për muajin Korrik ka kryer në total 80 inspektime në funksion të mbarëvajtjes së sezonit turistik, përkatësisht: 16 subjekte akomoduese, 31 subjekte Bar-Restorant/Fast-Food/Furrë Buke, 1 subjekt Pishinë (konstatuar i mbyllur), 32 subjekte tek Uji i Rrjetit.

Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor për muajin Korrik 2025. Shërbimi i Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor.

Puna në Shërbimin e Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor ka vijuar normalisht, duke u bazuar në në Ligjin Nr. 10138 datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik” i ndryshuar, Ligjin Nr. 15/2016 Për Parandalimin dhe Luftimin e Infeksioneve dhe Sëmundjeve Infektive, Ligjin Nr. 9942, datë 26.6.2008 Për parandalimin e çrregullimeve të shkaktuara nga pamjaftueshmëria e jodit në organizmin e njeriut. Vendimin Nr. 379 datë 25.05.2016 për miratimin e rregullores “Cilësia e ujit të pijshëm”, të gjitha protokollat shëndetësore si dhe në Rregulloren e brendshme të NJVKSH KUKES. - Është bërë mbledhja dhe përpunimi i të dhënave sipas tabelave të raportuara çdo muaj nga Qendrat Shëndetësore dhe janë raportuar përmes sistemit ALERT në SISI.

- Programi i imunizimit ka vijuar punën normalisht. Është bërë shpërndarja e vaksinave për muajin Korrik si për kalendarin e Kombëtar deri 18 vjeç por edhe vakcina e gripit për Fushatën e Gripit 2024-2025.

- Ka vijuar monitorimi i cilësisë së ujit të pijshëm në të gjitha pikat fundore të qytetit.

- Ka vijuar monitorimi i nivelit të zhurmave në pikat të ndryshme të qytetit.

- Gjatë këtij muaji kemi dërguar në IshP Tiranë 32 mostra PCR për gripin stinor, Covid19 dhe RSV të cilat kanë rezultuar negative.

III-Drejtimin e Task Forcave Vendore, Aktet-Normative dhe Urdhëra të Kryeministrit.

Sipas Planeve të Veprimit nga strukturat e specializuara gjatë muajit Janar 2025 nga ana e punonjësve të administratës së Prefektit të Qarkut janë ndjekur aktivitetet dhe veprimtaritë që kanë lidhje me;

Organin Këshillues pranë Prefektit të Qarkut,

Luftën kundër trafikimit dhe kultivimit të bimëve narkotike.

Luftën kundër trafikimit të personave nuk ka patur raste të trafikimit të personave apo viktime të mundshme të trafikimit.

Task - Forca për monitorimin e emergjencave në Qarkun e Kukësit.

Task - Forca për pagesën e energjisë elektrike dhe e ujit të pijshëm.

Task - Forca për mbrojtjen e pyjeve nga prerjet e paligjshme.

Task - Forca për Rendin dhe sigurinë e qarkullimit rrugor.

Task- Forca për sigurinë ushqimore në Qarkun e Kukësit.

IV-Marrëdhëniet e Prefektit të Qarkut me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.

Prefekti i Qarkut Kukës është bashkëpunues me Organet e Vetëqeverisjes Vendore duke i konsideruar ato aktorë kryesorë në punën dhe në marrëdhëniet me qytetarët për zgjidhjen e problemeve dhe të konflikteve që mund të ndodhin. Duhet thënë se komunikimi dhe bashkëpunimi ka qenë institucional dhe korrekt.

V-Për veprimtarinë e Organit Këshillues të Prefektit të Qarkut.

Organi Këshillues i Prefektit të Qarkut këtë muaj nuk ka trajtuar asnjë problematikë .

VI Gjendja CivileMe punonjësit e gjëndjes civile të njësive e vetqeverisjesvendore nuk kemi ndonjë problematikë gjatë këtij muaji. Janë lëshuar certifikata online të viteve 1930,1945,1970, etj, sipas kërkesave të qytetarëve. Vazhdon puna në këto zyra sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave në dhënjën e certifikatave nga E-Albania.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj.

P R E F E K T I
Dritan Baji

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Donald Korbi